



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KUSHTETUESE**  
**УСТАВНИ СУД**  
**CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 12 dhjetor 2011  
Nr. ref.: RK175/11

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**Rastin Nr. KI 92/11**

Parashtruesi

**Muhamet Bucaliu**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Njoftimit të Prokurorit të Shtetit KMLC. Nr. 37/11, të 2 qershorit 2011.**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar  
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Ivan Čukalović, gjyqtar  
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe  
Iliriana Islami, gjyqtare

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Parashtrues është z. Muhamet Bucaliu, me vendbanim në Ferizaj, i cili e dorëzoi kërkesën e parë (Rasti Nr. KI 20/10) në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) më 4 mars 2010. Rasti u hodh poshtë si i papranueshëm më 15 tetor 2010.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Me këtë kërkesë, parashtruesi e konteston Njoftimin e Prokurorit të Shtetit KMLC Nr. 37/11, të 2 qershorit 2011, me të cilin e refuzoi kërkesën e parashtruesit, të 13 majit 2011, për iniciimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë lidhur me Aktvendimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë Ac. Nr. 116/2011, të 19 prillit 2011. Njoftimi iu dërgua parashtruesit më 2 qershor 2011.

## **Objekti i çështjes**

3. Ky rast është vazhdim i Rastit Nr. KI 20/10. Parashtruesi tani ankohet që Gjykata Komunale në Ferizaj, me Aktvendimin 4/2008, të 13 dhjetorit 2010, ia shiti patundshmërinë e tij kreditorit përkundër kundërshtimeve të tij, dhe që Gjykata e Qarkut në Prishtinë, përmes Aktvendimit Ac. Nr. 116/2011, të 19 prillit 2011, e refuzoi ankesën e tij. Përveç kësaj, parashtruesi ankohet se Prokurori i Shtetit, me Memorandumin KMLC Nr. 37/2011, e njoftoi atë se nuk kishte bazë ligjore për të iniciuar procedurë për mbrojtje të ligjshmërisë.
4. Parashtruesi pohon që janë shkelur neni 24 (1) [Barazia para Ligjit], neni 31 (1) [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe neni 54 [Mbrojtja Gjyqësore] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).
5. Parashtruesi, gjithashtu kërkon që Gjykata të vendosë lidhur me kërkesën e tij për masë të përkohshme kundër procedurës përmbarrimore lidhur me pronën e tij për t'iu shmangur ndonjë rreziku për dëm të pariparueshëm.

## **Baza juridike**

6. Neni 113.7 i Kushtetutës, nenet 22 dhe 27 të Ligjit (Nr. 03/L-121) për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregulli 56 (2) i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatë**

7. Sa i përket rastit paraprak të parashtruesit, Rastit KI. Nr. 20/10, i 13 korrikut 2010, Gjykata Kushtetuese e shpalli kërkesën të papranueshme për shkak se parashtruesi kishte dështuar të tregonte se i kishte shteruar të gjitha mjetet juridike, siç parashihej me ligj, pasi ai ka mundur të ushtronte ankesë në Gjykatën Komunale në Ferizaj dhe në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë që nuk e kishte marrë Vendimin E. Nr. 04/08, të 11 janarit 2008 të Gjykatës Komunale në Ferizaj, dhe që e njëjta gjykatë, në vendimin e vet për përmbarrim, nuk kishte vendosur në lidhje me këtë rast brenda afatit të padisë. Në vend të kësaj, parashtruesi vetëm ushtroi padi kundër vlerësimit të vlerës së pronës.
8. Më 7 korrik 2011, parashtruesi e dorëzoi një kërkesë të re në këtë Gjykatë.
9. Më 17 gusht 2011, Kryetari, me Urdhrin Nr. GJR. 92/11, e caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović Gjyqtar raportues. Të njëjtën datë, Kryetari, me Urdhrin Nr. KSH. 92/11, e caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Robert Carolan (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Iliriana Islami.
10. Më 3 nëntor 2011, Gjykata e njoftoi Prokurorin e Shtetit për këtë kërkesë. Gjykata nuk ka marrë asnjë përgjigje deri më tani.

11. Më 25 nëntor 2011, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës për papranueshmëri të kërkesës.

### **Përmbledhje e fakteve**

12. Nga dokumentet e dorëzuara nga parashtruesi në lidhje me kërkesën e re, duket që, më 13 dhjetor 2010, Gjykata Komunale në Ferizaj mbajti seancën e tretë të shitjes publike të pronës së paluajtshme të parashtruesit (ngastra kadastrale Nr. 1071 në Ferizaj), e cila, sipas marrëveshjes mbi hipotekën (Nr. 1175/H, e regjistruar nga Zyra Komunale për Kadastër e Ferizajt nën numrin e protokollit 25-72217092-00584) me Raiffeisen Bankën si kreditor, ishte deponuar si garanci për një kredi që i ishte dhënë debitorit "Nera Impex" në Ferizaj. Sipas parashtruesit, asnjë blerës nuk ishte identifikuar.
13. Të njëjtën ditë, Gjykata Komunale në Ferizaj, me Aktvendimin E. 4/08, ia shiti pronën Raiffeisen Bankës, si ofertuesi më i lartë, përkundër kundërshtimeve të parashtruesit dhe të përfaqësuesit të tij kundër kësaj procedure të përbarimit.
14. Më 22 dhjetor 2010, parashtruesi ushtroi ankesë në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë kundër vendimit të Gjykatës Komunale, duke thënë se gjykata e shkallës së parë kishte bërë vlerësim të gabueshëm të gjendjes faktike.
15. Më 19 prill 2011, Gjykata e Qarkut në Prishtinë, me Vendimin Ac. Nr. 116/2011, e refuzoi padinë e parashtruesit si të pabazë dhe e konfirmoi Aktvendimin E. Nr. 04/2008, të 13 dhjetorit 2010, të Gjykatës Komunale në Ferizaj.
16. Më 13 maj 2011, parashtruesi parashtrroi kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Prokurorinë e Shtetit kundër vendimit të Gjykatës Komunale në Ferizaj dhe vendimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë.
17. Më 2 qershor 2011, Prokurori i Shtetit vërejti që nuk kishte pasur bazë ligjore për këtë kërkesë (Njoftimi KMLC Nr. 37/11).

### **Pretendimet e parashtruesit**

18. Parashtruesi pohon që:
  - a. Janë shkelur dispozitat e neneve 24.1, 31.1 dhe 54 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;
  - b. Është shkelur neni 47.2 i Ligjit për procedurën përbarimore sepse vendimi i Gjykatës Komunale E. Nr. 4/08, i 11 janarit 2008, kurrë nuk i ishte dorëzuar atij personalisht, prandaj ai nuk mund të ushtronte ankesë kundër këtij vendimi; dhe
  - c. Janë shkelur dispozitat ligjore të adresuara në kërkesën e 13 majit 2011, drejtuar Prokurorit të Shtetit, si dhe dispozitat e përmendura në ankesën e parë dhe në ankesat plotësuese.

### **Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës**

19. Në parashtresat e tij të reja, parashtruesi pohon që të drejtat e tij të garantuara me nenet 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës janë shkelur nga Gjykata Komunale në Ferizaj, Gjykata e Qarkut në Prishtinë dhe Prokurori i Shtetit.

20. Ankesa e parashtruesit se ai kurrë nuk e ka marrë Vendimin e Gjykatës Komunale në Ferizaj, E. Nr. 4/08, të 11 janarit 2008, ishte refuzuar nga kjo Gjykatë në Aktvendimin për Papranueshmëri në Rastin Nr. KI. 20/10, prandaj, në përputhje me rregullin 36 (3) të Rregullores së punës, ajo nuk do të shqyrtohet këtu.
21. Gjykata së pari vëren që, për të gjykuar për ankesën e re të parashtruesit, ajo së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i ka përmbushur të gjitha kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
22. Sa i përket kësaj kërkesë, Gjykata vëren që parashtruesi nuk mund të ankohej që gjykatat e rregullta kanë bërë lajthim të fakteve apo të ligjit, përveç nëse ato mund t'i kenë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë. Kjo është e vërtetë për procedurën kryesore, si dhe për procedurën përmbartimore pas përfundimit të gjykimit aktual. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet Aktgjykimit të GJEDNJ-së të 19 marsit 1997, Hornsby kundër Greqisë (Raportet 1997, 495), me ç'rast GJEDNJ theksoi se "përmbartimi i një aktgjykimi të shqiptuar nga cilado gjykatë duhet të konsiderohet pjesë përbërëse e "gjykimit" për qëllime të nenit 6".
23. Në këtë drejtim, Gjykata Kushtetuese thekson që nuk është gjykatë e shkallës së katërt, me rastin e shqyrtimit të vendimeve të nxjerra nga gjykatat e rregullta. Është detyrë e gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, García Ruiz kundër Spanjës [DHM], Nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).
24. Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse provat para gjykatave dhe organeve të tjera janë paraqitur në mënyrë përkatëse dhe nëse procedurat në përgjithësi, shikuar në tërësinë e tyre, janë zhvilluar në mënyrë të duhur saqë parashtruesi i kësaj kërkesë ka pasur gjykim të drejtë (shih, *mutatis mutandis*, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në rastin Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, Kërkesa Nr. 13071/87, e miratuar më 10 korrik 1991).
25. Sa i përket kësaj kërkesë, Gjykata konsideron që Gjykata e Qarkut në Prishtinë, në Aktvendimin e vet, Ac. Nr. 116/11, të 19 prillit 2011, me kujdes e shqyrtoi mënyrën në të cilën Gjykata Komunale në Ferizaj e kishte trajtuar shitjen publike të pronës së hipotekuar të parashtruesit në përputhje me marrëveshjen mbi hipotekën, të regjistruar në Drejtorinë për Kadastër në Ferizaj. Po ashtu, Prokurori i Shtetit nuk gjeti baza ligjore për iniciimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë.
26. Prandaj, parashtruesi nuk ka treguar që Aktvendimi Ac. Nr. 116/11, i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, ishte i padrejtë apo i prekur nga arbitrariteti (shih, *mutatis mutandis*, Shub kundër Lituaniës, Vendimi i GJEDNJ-së për Pranueshmëri të Kërkesës, Nr. 17064/06, i 30 qershorit 2009, dhe Vanek kundër Republikës së Sllovakisë, Vendimi i GJEDNJ-së për Pranueshmërinë e Kërkesës Nr. 53363/99, i 31 majit 2005)) dhe përbënte shkelje të të drejtave kushtetuese në të cilat thirret parashtruesi.
27. Në këto rrethana, Gjykata konkludoi që kërkesa është qartazi e pabazuar në përputhje me rregullin 36 (1.c) të Rregullores së punës, i cili thotë: "*Gjykata mund të shqyrtojë Kërkesat vetëm nëse: c) Kërkesa është qartas e bazuar*".
28. Prandaj, kërkesa e parashtruesit duhet të hidhet poshtë si e papranueshme.

## **Vlerësimi i kërkesës për masë të përkohshme**

29. Sa i përket kërkesës së parashtruesit drejtuar Gjykatës për masë të përkohshme, Gjykata i referohet nenit 27 të Ligjit dhe, në veçanti, rregullit 54 (1) të Rregullores së punës, i cili thotë që, në çfarëdo kohe përderisa kërkesa është e pazgjidhur para Gjykatës dhe meritat e kërkesës nuk janë vendosur nga Gjykata, pala mund të kërkojë vendosjen e masës së përkohshme. Megjithatë, duke marrë parasysh që kërkesa u shpall e papranueshme, parashtruesi nuk ka të drejtë, sipas rregullit 54 (1) të Rregullores së punës, të kërkojë masë të përkohshme.

### **PËR KËTO ARSYE**

Në mbështetje të rregullit 36 (1.c), rregullit 54 (1) , rregullit 56 (2) të Rregullores së punës, Gjykata Kushtetuese më 25 nëntor 2011, njëzëri

### **VENDOSI**

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. TA HEDHË POSHTË kërkesën për Masë Përkohshme;
- III. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese;
- IV. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Gjyqtari raportues**

Ivan Čukalović

**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Prof. dr. Enver Hasani

